



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and Tourism

Datë:	30.12.2024
Për:	z.Smajl Latifi, Kryetar i Komunës
Nga:	Erhan Morina-Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Lënda:	Plani i punës për vitin 2025



DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në kuadër të Komunës së Rahovecit ka një rol kyç në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë së zhvillimit, siguron koordinim vertikal dhe horizontal dhe komunikim me të gjithë aktoret relevantë në proces, si brenda administratës komunale ashtu edhe me nivelin qendror, komunitetin dhe më gjerë.

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm do të punojë sipas planit të punës të përgatitur në mënyrë profesionale dhe do të ndërmarrë veprime të përcaktuara qartë dhe harmonizuara me objektivat strategjike të Strategjisë Zhvillimore Komunale si dhe dokumente tjera programore që kanë për qëllim ndikimin në përmirësimin dhe avansimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik do të ndërmarrë iniciativa të cilat qojnë në arritje të rezultateve konkrete dhe do t'i kushtohet vëmendje komunikimit konstruktiv me të gjitha institucionet relevante në nivel lokal dhe qendror, me donatorë, si dhe investitorë potencial të huaj dhe vendor.

Një synim tjetër ku do të kemi çasje pro aktive do të jetë joshja e investitorëve vendor dhe të huaj përmes ofrimit të informatave profesionale relevante. Në anën tjetër do të identifikohen bizneset të cilat kanë interesim për të zgjeruar aktivitetin e tyre biznesor dhe për të hyrë në partneritet me investitorë potencial.

DEZHT do të jetë e kyçur aktivisht edhe sa i përket implementimit të të gjitha projekteve të financuara nga ana e donatorëve të ndryshëm me qëllim të koordinimit të aktiviteteve dhe maksimizimit të efektit

KOMUNA RAHOVEC

të rezultateve të pritshme, e në të njëjtën kohë do të angazhohet edhe për identifikimin e donatorëve të mundshëm potencial në rastet dhe projektet që mund të identifikohen në ndërkohë gjatë këtij viti.

OBJEKTIVAT KRYESORE TË PUNËS

- Hulimtimin e mundësive për të siguruar donacione dhe burime të tjera financiare për realizimin e projekteve zhvillimore;
- Hartimin e programeve sipas veprimtarive dhe sektorëve të ndryshëm ekonomik dhe përgatitjen e propozimeve konkrete për projekte të rëndësishme të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorëve të veçantë,
- Ofrimin e shërbimeve për regjistrimin e bizneseve - Qendra e Regjistrimit të Bizneseve;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i projekteve lidhur me Partneritet Publiko Privat;
- Bashkëpunimin me Institucionet Ndërkombëtare dhe organizatave të ndryshme financiare për projekte të ndryshme zhvillimore e sidomos në projekte të investimeve kapitale;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me Organizatat jo Qeveritare që mund të përkrahin me projektet ideore të cilat kanë në fokus promovimin dhe zhvillimin ekonomik lokal;
- Bashkëpunimi i ngushtë me bizneset lokale lidhur me përmirësimin e klimës për të bërë biznes;
- Komunikimin e vazhdueshëm me investitor potencial vendor dhe të huaj përfshirë diasporën me qëllim të informimit lidhur me lehtësirat, planet zhvillimore, projektet dhe mundësitë praktike që ofron Komuna në raport me investitorët;
- Promovimin e potencialeve turistike të komunës së Rahovecit në ndërlidhje me pakot e mundshme turistike në bashkëpunim me komunat e tjera të rajonit;
- Dhënja e pronave komunale përmes ankandeve publike, me qëllim të krijimit dhe zgjerimit të mundësive që pronat komunale të shfrytëzohen për aktivitete afariste.
- Rritja e projekteve investuese në PPP.

Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, brenda kornizave ligjore dhe financiare, DEZHT për vitin 2025, planifikon të zhvilloj këto aktivitete:

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

- Shpërndarja e të gjitha aktvendimeve dhe ngarkesave në taksa afariste për bizneset të cilat ngarkohen sipas rregullores për taksa komunale 01 NR 80/20;
- Në bashkëpunim me AZHR-në, do të organizohen sesione informuese për të aplikuar në thirrjet e granteve në ministri të ndryshme;
- Takim i këshillit publiko-privat, shqyrtimi i kërkesave të bizneseve cilat operojnë në komunën e Rahovecit;
- Vazhdim i angazhimit të të rinjëve për praktikë me pagesë në sektorin publik;
- Menaxhimi i shtëpisë për të moshuar;

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim
Adresa: Xhelal Hajda – Toni p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +381 29 276 425
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>

- Zhvillimi i agro-turizmit përmes realizimit të projektit: “Investime në Turizëm”, ku planifikohet ndërtohen bujtina në fshatin Zoqisht, meremetimi i “Kroit të Demirit” në fshatin Drenoc, ndërtimi shtigjeve të ecjes në Zatriq dhe Zoqisht, investime te “Shpella e Dagonit”, si dhe sinjalizimi vertikal i të gjitha pikave turistike në Komunën e Rahovecit.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

- Organizimi i ankandeve publike për pronat e lira komunale;
- Mbikëqyrja dhe Inkasimi i të hyrave në qira dhe Inkasimit të të hyrave në taksa afariste komunale;
- Zbatimi i politikave zhvillimore përmes ndarjes së subvencioneve për bizneset të vogla dhe të mesme;
- Ofrimi i shërbimeve për regjistrimin e bizneseve, si dhe ofrimi i shërbimeve sipas kërkesave të bizneseve.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

- Aplikimi për projekte investive në MZHR, për grantet e vitit 2026;
- Vizita dhe promovim i bizneseve të komunës së Rahovecit;
- Takim në mes të bizneseve në Rahovec dhe atyre në Diaspor-mundësia e rritjes së bashkëpunimit në mes tyre.
- Festa e Vjeljes së Rrushit 2024;

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

- Regjistrimi i të gjitha aseteve komunale;
- Në periudhën e katërt të vitit padyshim që prioritet i DEZHT mbetet realizimi i buxhetit në përpikmëri si dhe rritja e të hyrave komunale nëpërmjet inkasimit të të hyrave nga taksat dhe qiraja.

Prioritet i lartë:

- Zbatimi i memorandumit të bashkëpunimit me MINT, deri në realizimin e plotë të Projektit: “Ndërtimi i Parkut Industrial në Opterushë”;
- Krijimin e hapësirave të reja për biznese;
- Do të ofrohet konsulencë falas në përgatitjen e aplikacioneve për të gjitha bizneset të cilat dëshirojnë të aplikojnë për grante në ministri të ndryshme.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim
 Adresa: Xhelal Hajda – Toni p.n. Rahovec, Kosovë
 Tel: +381 29 276 425
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>